

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e
Legjislacionit Mjedisor**

Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian

Projekt-Urdhër i brëndshëm
për Formatin e raporteve për Impiantet e Mëdha me Djegie, në
zbatim të Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”¹

Drafti 1

Versioni 2

02.06. 2011

¹ Ky Urdhër transponon Nenin 15 të Direktivës 2001/80/EC Për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha me djegie, për aq sa i përket përmbajtjes së raporteve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRI I MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

URDHËR I BRËNDSHËM

Drafti 1

Versioni 2

02.06. 2011

Nr. _____, datë _____

PËR

Formatin e raporteve për Impiantet e Mëdha me Djegie, në zbatim të Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”²

Në mbështetje të Nenit 100 të Kushtetutës dhe Nenit 56 dhe Seksionit 4 të kreut 2 të Ligjit nr ____, datë _____ “Për Lejet e Mjedisit”,

URDHEROJ:

1. Ministria të përgatisë dhe të publikojë:
 - a. Raportin e ndërmjetëm mbi rezultatet e zbatimit të programeve për pakësimin e shkarkimeve nga impiantet e mëdha ekzistuese me djegie, të hartuar prej saj në zbatim të nenit 20 të Ligjit, në mes të çdo faze të zbatimit të këtyre programeve;

²Ky Urdhër transponon Nenin 15 të Direktivës 2001/80/EC Për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e mëdha të djegies, për aq sa i përket përmbajtjes së raporteve.

- b. Raportin përmbledhës mbi zbatimin e programeve të referuar në shkronjën a, të paktën një vit pas përfundimit të fazave të ndryshme të tyre.
2. Raportet e referuara më lart duhet të japin informacion të përgjithshëm mbi:
 - a. të gjitha impiantet me djegie të trajtuara në Seksionin 4 të kreut 2 të Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”; lidhur me zbatimin e
 - b. shkarkimet e dioksidit të squfurit dhe oksideve të azotit të shprehura në ton/vit dhe si përqendrime të këtyre substancave në mbetjet e gazta;
 - c. masat e marra apo të parashikuara për pakësimin e shkarkimeve dhe të ndryshimeve në zgjedhjen e lëndës djegëse të përdorur;
 - d. ndryshimet e bëra apo të parashikuara në metodën e operimit;
 - e. mbylljen përfundimtare të impianteve me djegie që ka ndodhur apo parashikohet të ndodhë;
 - f. vlerat kufi të shkarkimeve të imponuara nga programet e impianteve ekzistuese, sipas rastit.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për përcaktimin e shkarkimeve dhe përqendrimeve vjetore të ndotësve në mbetjet e gazta të mbështetet në Nenin 26 të Ligjit.
4. Raportet duhet të informojnë për zbatimin e Shënimit të Shtojcës 3, Pjesa A të Ligjit.
5. Raportet duhet të informojnë për zbatimin e Shënimeve të Pjesës A të Shtojcës 6 të Ligjit.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

FATMIR MEDIU